



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 30 shtator 2024
Nr. ref.: RK 2552/24

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI234/23

Parashtrues

Q. I.

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Pml. nr. 495/2023 të Gjykatës
Supreme të Republikës së Kosovës, të 3 tetorit 2023**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar,
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Q. I. (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet nga Ylli Bokshi, avokat nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Pml. nr. 495/2023], të 3 tetorit 2023 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme).
3. Aktgjykimin e kontestuar [Pml. nr. 495/2023], të 3 tetorit 2023 të Gjykatës Supreme, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës e ka pranuar më 12 tetor 2023.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe nenin 50 [Të Drejtat e Fëmijës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ) dhe nenin 3 të Konventës për Drejtat e Fëmijëve.
5. Parashtruesi i kërkesës kërkon moszbulimin e identitetit në procedurë para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon nga Gjykata caktimin e masës së përkohshme.

Baza juridike

7. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 01/2023 (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

8. Më 23 tetor 2023, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
9. Më 30 tetor 2023, Kryetarja e Gjykatës, përmes Vendimit [nr. GJR. KI234/23] caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Safet Hoxha dhe Remzije Istrefi-Peci (anëtarë).
10. Më 6 nëntor 2023, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës.
11. Më 6 nëntor 2023, Gjykata ia dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
12. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.

13. Më 26 qershor 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës dhe e dëmtuara F. C. janë fqinjë dhe jetojnë në Gjakovë.
15. Po ashtu nga shkresat e dorëzuara në kërkesë rezulton se Prokuroria Themelore në Gjakovë, Departamenti për të Mitur, më 30 janar 2021, ka ngritur aktakuzën PP/I. nr. 297/2022, kundër të akuzuarit Q. I. nga Gj..., për shkak të veprës penale sulmi seksual nga neni 229, paragrafi 5 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).
16. Më 19 prill 2023, me Aktgjykimin nr. 2022; 230076 Gjykata Themelore në Gjakovë, parashtruesin e kërkesës e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 vite e 6 muaj, në të cilin dënim iu është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga 4 nëntori 2022 gjer më 19 prill 2023. Në arsyetimin e Aktgjykimit, Gjykata Themelore në par. 7 (gjendja faktike e vërtetuar) kishte përmbledhur: *“Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike se i akuzuari ka kryer veprën penale të sulmit seksual nga neni 229, paragrafi 5 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi”*.
17. Kundër këtij Aktgjykimi, brenda afatit ligjor, mbrojtja e parashtruesit të kërkesës kishte paraqitur ankesë, në Gjykatën Apelit të Kosovës për shkak të: i) shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale; ii) vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike; iii) shkeljeve të ligjit penal dhe iv) vendimit lidhur me sanksionin penal dhe shpenzimet e procedurës penale.
18. Gjykata e Apelit të Kosovës, me Aktgjykimin PAKR. nr. 371/2023 të 5 korrikut 2023 kishte refuzuar ankesën e parashtruesit, duke vërtetuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë, 2022; 230076 të 19 prillit 2023.
19. Në arsyetimin e saj, Gjykata e Apelit në pjesën përmblyllëse kishte konstatuar se: *“Kolegji për të mitur i kësaj gjykate, vlerëson se dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë është dënim i drejtë, i ligjshëm, në harmoni me peshën e veprës penale dhe rrezikshmërisë shoqërore të kësaj vepre penale të kryer dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit”*.
20. Më 13 shtator 2023, përfaqësuesi i parashtruesit ka paraqitur kërkesë për Mbrojtje të Ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës për shkak: i) të shkeljes së ligjit penal; ii) të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale; dhe iii) të shkeljes së dispozitave të procedurës penale, të cilat shkelje kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimeve gjyqësore të atakuara, me kërkesën që kjo gjykatë të anulonte Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR. nr. 371/23, të 5 korrikut 2023 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti për të Mitur 2022:230076, të 19 prillit 2023 dhe çështjen t’ ia kthente në rigjykim Gjykatës Themelore në Gjakovë, apo që të njëjtat t’i anulonte, duke e liruar nga akuza të gjykuar, përkatësisht parashtruesin e kërkesës.
21. Më 3 tetor 2023, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, me Aktgjykimin Pml. nr. 495/2023 vendosi të refuzonte si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit Q. I., e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti për të Mitur, me numër 2022:230076 të 19 prillit 2023 dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR. nr. 371/2023 të 5 korrikut 2023.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe nenin 50 [Të Drejtat e Fëmijës] të Kushtetutës të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme Kushtetuta), në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ) dhe nenin 3 të Konventës për Drejtat e Fëmijëve.
23. Parashtruesi në raport me shkeljen e pretenduar të nenit 3 të Kushtetutës, ka theksuar në kërkesë se: *“Në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, në nenin 3 [Barazia para Ligjit] parashtruesit të kërkesës Q. I. i është garantuar se i njëjti do të trajtohet si gjithë qytetarët e tjerë, përkatësisht rasti i tij duhet të trajtohet si në rrethanat dhe seriozitetin e rastit të zonjës S. Z. S, sipas Aktgjykimit [KI161/21](#), i Gjykatës Kushtetuese, nisur nga parimi i barazisë para ligjit dhe do t’i respektohen në mënyrë të plotë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht”*.
24. Lidhur me shkeljen e pretenduar të nenit 22 të Kushtetutës, parashtruesi thekson në kërkesë se: *“marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare që kanë zbatim të drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës, ndër to edhe Konventa për të Drejtat e Fëmijëve dhe Konventa e Stambollit. Detyrimet që dalin nga këto instrumente ndërkombëtare afektojnë, ndër të tjera, edhe respektimin e garancive procedurale gjatë zhvillimit të një procedure penale, siç janë rrethanat në rastin konkret. Gjykata e shkallës së parë në kuptim të detyrimeve ex officio është dashur që të miturën ta merr në pyetje në prani të psikologut, këtë duke ju referuar nenit 50 të Kushtetutës, dhe nenit 3 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës dhe Konventës së Stambollit”*. Më tej, në mënyrë specifike përmend Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KI161/21 të S. Z. S., duke theksuar se Gjykata ka vënë standard ashtu që në paragrafin 150 të atij Aktgjykimi ka konstatuar: *“...Gjykata vë në dukje se nuk mund të ketë administrim adekuat dhe vlerësim të drejtë të dëshmisë së një fëmije, dëshmitarë të vetëm okular të ngjarjes përkatëse, pa mbështetje profesionale”*.
25. Në raport me nenin 31 të Kushtetutës lidhur me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi në kërkesë pretendon se *“Marrja e dëshmisë e të miturës — të dëmtuarës, pa praninë e një psikologu, marrë parasysh rrethanat dhe ndjeshmërinë e rastit konkret, përbën shkelje të garancive procedurale të përcaktuara përmes nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Kjo, duke pasur parasysh që e dëmtuara ka qenë dashur të dëshmojë para gjykatës për një pretendim shumë të rëndë të cilin e kanë iniciuar prindërit e saj ndaj parashtruesit të kërkesës”*.
26. Pretendimet shtesë të parashtruesit për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës lidhur me nenin 6 të KEDNJ-së, kryesisht konsistojnë në faktin që ai pretendon se një pjesë e pretendimeve të ngritura nga ai para gjykatave të rregullta lidhur me kundërshtimet e tij për ligjshmërinë e provave nuk janë shqyrtuar dhe se kjo ka rezultuar në shkeljen e të drejtës për vendim të arsyetuar gjyqësor.
27. Si referenca mbështetëse për këtë shkelje të pretenduar, parashtruesi ka potencuar në kërkesën e tij Aktgjykimin [KI07/18](#), me parashtrues *Çeliku Rollers SH.P.K.*, duke shtuar se parimet e kësaj të drejte Gjykata i ka shtjelluar në rastet [KI72/12](#), [KI97/16](#), [KI143/16](#) dhe [KI24/17](#), si dhe disa raste të GJEDNJ-së si *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykimi 19 prillit 1994.

28. Sa i përket pretendimeve lidhur me nenin 50 të Kushtetutës [të drejtat e fëmijës], nenit 3 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës dhe Konventës së Stambollit, parashtruesi nuk ka specifikuar qartë se si janë shkelur këto të drejta të garantuara me Kushtetutë dhe aktet juridike të përmendura në kërkesë, porse shkeljen e tyre kryesisht e ka justifikuar me marrjen në pyetje të të dëmtuarës, pa prani të psikologut dhe ka supozuar se kjo ka ndikuar në drejtësinë e procesit kundër parashtruesit, gjithnjë duke marrë shembull Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KI161/21.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 3 [Barazia para Ligjit]

1. *Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore.*

2. *Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.*

Neni 22

[Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]

Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:

[...]

(2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;

[...]

(7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës;

[...]

Amendamenti nr. 26 [i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 25 shtator 2020, i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovë, më 30 shtator 2020];

Në nenin 22, pas paragrafit (8) shtohet paragrafi (9) si në vijim:

(9) Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje.

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

- Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
- Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij*

brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të mediave, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.

4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.

5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.

Neni 50 **[Të Drejtat e Fëmijës]**

1. Fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre.

[...]

3. Secili fëmijë gëzon të drejtën për të qenë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi dhe eksploatimi.

4. Të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërmarra qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, do të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve.

5. Secili fëmijë gëzon të drejtën për raporte të rregullta personale dhe kontakte të drejtpërdrejta me prindërit e vet, me përjashtim kur institucioni kompetent përcakton se një gjë e tillë është në kundërshtim me interesat më të mira të fëmijës.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6 **(E drejta për një proces të rregullt)**

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë.

2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës Kundër Grave dhe Dhunës në Familje [e miratuar më 7 prill 2011 nga Këshilli i Evropës si dhe e përfshirë në listën e Konventave dhe instrumenteve ndërkombëtare ligjore në nenin 22 të Kushtetutës përmes Amendamentit nr. 26, të 28 shtatorit 2020]

Kapitulli I **Qëllimet, përkufizimet, barazia dhe mosdiskriminimi, detyrime të përgjithshme**

Neni 3 Përkufizimet

[...]

(b) "Dhunë në familje" nënkupton të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodhin brenda familjes ose njësisë shtëpiake, ose ndërmjet ish-bashkëshortëve ose partnerëve ose ndërmjet bashkëshortëve ose partnerëve aktualë, pavarësisht nga fakti nëse autori i veprës penale ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën.

[...]

Kapitulli IV Mbrojtja dhe mbështetja

Neni 18 Detyrimet e përgjithshme

[...]

3. Palët garantojnë që masat e marra sipas këtij kapitulli: – të bazohen në një perceptim gjinor të dhunës kundër grave dhe dhunës në familje dhe të fokusohen tek të drejtat e njeriut dhe siguria e viktimës; – të bazohen në një përqsasje të integruar, e cila merr parasysh marrëdhënien midis viktimave, autorëve të veprave penale, fëmijëve dhe mjedisit të tyre më të gjerë social; – të synojnë shmangien e viktimizimit dytësor; – të synojnë fuqizimin dhe pavarësinë ekonomike të grave, viktima të dhunës; – të lejojnë, sipas rastit, një gamë mbrojtjeje dhe shërbimesh mbështetëse që duhet të vendosen në të njëjtat ambiente; – të trajtojnë nevojat specifike të personave të pambrojtur, duke përfshirë viktimat fëmijë dhe t'u vihen në dispozicion.

4. Sigurimi i shërbimeve nuk varet nga gatishmëria e viktimës për të ngritur akuza ose për të dëshmuar kundër një autori vepre penale.

5. Palët marrin masat e duhura për të ofruar mbrojtje konsullore dhe mbrojtje dhe mbështetje tjetër për shtetasit e tyre dhe viktima të tjera që kanë të drejtën e kësaj mbrojtjeje, në përputhje me detyrimet e tyre sipas të drejtës ndërkombëtare.

KONVENTA PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE

Neni 3

1. Në të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucionet publike ose private të mirëqenies shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsideratë parësore.

2. Shtetet palë angazhohen që t'i sigurojnë fëmijës mbrojtjen dhe kujdesin e nevojshëm për mirëqenien e tij, duke pasur parasysh të drejtat dhe detyrat e prindërve të tij, të kujdestarëve të tij ligjor ose të personave të tjerë ligjërisht përgjegjës për të dhe, për këtë qëllim, ato marrin të gjitha masat legjislative dhe administrative përkatëse.

3. Shtetet palë sigurojnë që institucionet, shërbimet dhe qendrat përgjegjëse për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve të veprojnë në përputhje me normat e caktuara nga autoritetet kompetente, veçanërisht në fushën e sigurisë, të shëndetit, të numrit dhe të aftësive të personelit të tyre si dhe të mbikëqyrjes së duhur.

KODI NR. 06/L-074 PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 229 Sulmi seksual

1. Kushdo që prek personin tjetër me qëllim seksual ose e cyt personin e tillë të prekë kryesin apo personin tjetër për qëllim seksual, pa pëlqimin e personit të tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vjet.

2. Kushdo që prek personin tjetër me qëllim seksual ose e cyt personin tjetër të prekë kryesin apo personin e tretë për qëllim seksual në një ose më shumë prej rrethanave në vijim, dënohet me burgim prej një (1) deri në shtatë (7) vjet:
[...]
5. Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet ndaj personit nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet, kryesi dënohet me burgim prej pesë (5) deri në dhjetë (10) vjet

KODI NR. 04/L-123 I PROCEDURËS PENALE

Neni 7

Detyrimi i përgjithshëm për vërtetimin e plotë dhe të saktë të fakteve

[...]

2. Sipas dispozitave të parapara me këtë kod, Gjykata, Prokurori i Shtetit dhe Policia që marrin pjesë në procedurë penale detyrohen që me vëmendje dhe me përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë të vërtetojnë faktet kundër të pandehurit si dhe ato në favor të tij, dhe para fillimit të procedurës dhe gjatë zhvillimit të saj t'i mundësojnë të pandehurit dhe mbrojtësit të tij shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të të pandehurit.

Neni 9

Barazia e palëve

[...]

2. I pandehuri ka të drejtë të deklarohet dhe atij duhet t'i lejohet deklarimi për të gjitha faktet dhe provat që e ngarkojnë dhe t'i paraqesë të gjitha faktet dhe provat që janë në favor të tij. Ai ka të drejtë që të kërkojë nga Prokurori i Shtetit të thërras dëshmitarë në emër të tij. Ai ka të drejtë t'i marrë në pyetje dëshmitarët kundër tij dhe të kërkojë praninë dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta që vlejnë për dëshmitarët kundër tij.

Neni 130

Kushtet e përgjithshme për marrjen në pyetje në procedurë paraprake, marrjen e deklaratës në procedurë paraprake ose mundësinë hetuese të veçantë

[...]

5. Me rastin e marrjes në pyetje të personit i cili nuk ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet, sidomos kur ai është dëmtuar me veprën penale veprohet me kujdes që pyetja të mos ndikojë dëmshëm në gjendjen e tij mendore. **Kur është e nevojshme**, ai pyetet me ndihmën e psikologut për fëmijë ose pedagogut për fëmijë apo ekspertit tjetër profesional.

Pranueshmëria e kërkesës

29. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

30. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht u referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

31. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale], nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe nenit 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.

32. Sa i përket përmbushjes së kriterëve të mësipërme, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është: (i) palë e autorizuar, (ii) konteston një akt të një autoriteti publik, respektivisht Aktgjykimin Pml. nr. 495/2023 të 3 tetorit 2023 të Gjykatës Supreme, në ndërlidhje me dy aktgjykimet e shkallëve më të ulëta gjyqësore, (iii) kryesisht i ka sqaruar pretendimet e tij për të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur (iv) ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj, dhe (v) e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar ligjor.

33. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Paragrafi (2) i rregullit 34 të Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Më konkretisht, rregulli 34 (2) përcakton që:

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

34. Rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpall një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse vlerësohet se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si "qartazi e pabazuar" në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë në vete.
35. Në këtë drejtim, pretendimet e tilla, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime "të shkallës së katërt"; (ii) pretendime që kategorizohen me një "mungesë" të dukshme ose evidente të shkeljes"; (iii) pretendime "të pambështetura apo të paarsyetuara"; dhe në fund, (iv) pretendime "konfuze dhe të paqarta".
36. Në këtë kontekst, në mënyrë që të vlerësojë pranueshmërinë e kërkesës, dhe faktin nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata fillimisht do të rikujtojë thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
37. Në dritën e kësaj kornize normative, Gjykata sjellë në vëmendje se çështja thelbësore në rrethanat e rastit konkret, ndërlidhet me pretendimin e parashtruesit të kërkesës lidhur me moszbatimin e drejtë të ligjit, në mënyrën a marrjes së provave, marrjen në pyetje të të dëmtuarës pa prani të psikologut, si dhe mosarsyetimin e vendimeve gjyqësore në raport me pretendimet e tij ankimore.
38. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se në thelb pretendimet për shkelje të neneve 3, 22, 31 dhe 50 të Kushtetutës, nenit 6 të KEDNJ-së, nenit 3 të Konventës për Mbrojtjen e të drejtave të Fëmijëve dhe të Konventës së Stambollit - janë paraqitur të ndërlidhura dhe mbi bazën e argumenteve dhe arsyetimeve të njëjta ose gati tërësisht të ngjashme, andaj si të tilla, Gjykata do t'i trajtojë së bashku. Pretendimin lidhur me nenin 32 të Kushtetutës, Gjykata do ta trajtojë ndaras.
39. Parashtruesi i kërkesës ka theksuar se Kushtetuta e Kosovës në nenin 3 garanton barazinë para ligjit si parim, andaj parashtruesit i garantohet se do të trajtohet si i barabartë dhe se rasti i tij duhet të trajtohet si i barabartë me rastet tjera e veçanërisht me rrethanat dhe seriozitetin e rastit [KI161/21](#) , i Gjykatës Kushtetuese. Më tej, edhe pretendimin për shkelje të nenit 22 e arsyeton ngjashëm si: *"marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare që kanë zbatim të drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës, ndër to edhe Konventa për të Drejtat e Fëmijëve dhe Konventa e Stambollit. Gjykata e shkallës së parë në kuptim të detyrimeve ex officio është dashur që të miturën ta merr në pyetje në prani të psikologut, këtë duke ju referuar nenit 50 të Kushtetutës, dhe nenit 3 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës dhe Konventës së Stambollit"*.
40. Shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës lidhur me nenin 6 të KEDNJ-së prapë e arsyeton si në vijim: *"Marrja e dëshmisë e të miturës — të dëmtuarës, pa praninë e një psikologu, marrë parasysht rrethanat dhe ndjeshmërinë e rastit konkret, përbën shkelje të garancive procedurale të përcaktuara përmes nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Kjo, duke pasur parasysht që e dëmtuara ka qenë dashur të dëshmoj para*

gjykatës për një pretendim shumë të rëndë të cilën e kanë iniciuar prindërit të saj ndaj parashtruesit të kërkesës". Më tutje, lidhur me nenin 31, parashtruesi i kërkesës thekson se provat e shqyrtuara kundër parashtruesit të kërkesës në gjykim e sidomos e atyre të marra nga telefoni që ka shfrytëzuar e dëmtuara janë marrë kundërligjshëm dhe gjykatat nuk iu kanë përgjigjur pretendimeve të ngritura nga mbrojtja, andaj kjo ka rezultuar me shkeljen e të drejtës në vendim të arsyetuar gjyqësor.

41. Lidhur me nenin 50 Kushtetutës [Të drejtat e fëmijës] lidhur me nenin 3 të Konventës për Mbrojtjen e fëmijëve, nuk ka dhënë pretendime specifike përpos citimit të rastit të Gjykatës Kushtetuese KI161/21, duke theksuar se Gjykata ka vënë standard ashtu që në pikën 150 të atij Aktgjykimi ka konstatuar: "... Gjykata vë në dukje se nuk mund të ketë administrim adekuat dhe vlerësim të drejtë të dëshmisë së një fëmije, dëshmitarë të vetëm okular të ngjarjes përkatëse, pa mbështetje profesionale". Konventën e Stambollit parashtruesi i kërkesës e ka përmendur si instrument ndërkombëtar, pa përcaktuar qartë as cila dispozitë e as si ka ndodhur shkelja eventuale e kësaj Konvente.
42. Gjykata, në këtë kontekst, thekson se të gjitha pretendimet e lartpërmendura në thelb i referohen Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KI161/21 dhe konstatimit se "*dëgjimi i një dëshmitari të mitur nga gjykata në atë rast pa psikolog, shkeli drejtësinë e procesit*", prandaj të njëjtat standarde Gjykata duhet të zbatojë edhe në rastin e parashtruesit të kërkesës.
43. Mirëpo, sikurse do të sqarojë në vijim, Gjykata thekson që rrethanat e këtij rasti dallojnë nga rasti i sipërtheksuar. Po ashtu, Gjykata rithekson vlerësimin e saj në rastin [KI184/19](#) (parashtrues *Naser Gashi* Aktvendim i 17 gushtit 2020-paragrafi 59, ku kishte theksuar: "... Gjykata gjithashtu dëshiron të theksoj se secili rast para Gjykatës Kushtetuese ka veçantitë dhe specifikat e veta, të cilat mund të jenë arsye e mjaftueshme që Gjykata të gjejë shkelje specifike. Megjithatë, çdo referencë në aktgjykime të tilla dhe krahasimi i rastit të tij me raste të tilla nuk është arsye dhe bazë e mjaftueshme që Gjykata, edhe në rastin konkret, të gjejë shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë".
44. Bazuar në si më sipër, Gjykata konstaton se përkundër pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për njëllojshmërinë e pozicioneve të parashtruesit dhe të parashtrueses në rastin KI161/21 dhe rrjedhimisht edhe pritshmërisë për trajtim të njëjtë të rasteve, Gjykata thekson se ka ndryshime esenciale në mes tyre, për arsyet si në vijim:
 - i. *veprat penale për të cilat parashtruesit ishin akuzuar dhe shpallur fajtorë nga gjykatat e rregullta ishin të natyrave të ndryshme (vrasje e rëndë, e para, sulm seksual, e dyta);*
 - ii. *F.C. në rastin e parashtruesit ishte viktimë e drejtpërdrejtë e veprimeve të parashtruesit dhe po merrej në pyetje si e dëmtuar–dëshmitare;*
 - iii. *I mituri dëshmitar në rastin KI161/21 ishte i privuar nga mbrojtja e të dy prindërve (njëri–parashtruesja ishte në burg si kryes i veprës penale e tjetri ishte viktimë e vrasjes), andaj Gjykata me të drejtë konstatoi duke marrë për bazë rrethanat specifike të rastit se mbështetja profesionale e psikologut ishte e nevojshme dhe në interesin më të mirë të fëmijës. Ndërsa, në rastin e tanishëm të parashtruesit e dëmtuara F. C. që në deklaratën e saj fillestare në stacionin policor e kishte dhënë në prani të nënës së saj A. C., kurse babai i të dëmtuarës ishte i pranishëm në gjykim, dha deklaratë në seancë gjyqësore, si dhe paraqiti dëshmi lidhur me të dëmtuarën F. C. (bijën e tij) dhe raportet e saj edhe të familjes së tyre me parashtruesin e kërkesës.*
 - iv. *Gjykata, në rastin KI161/21 gjeti shkelje të nenit 31 të Kushtetutës lidhur me nenin 6 të KEDNJ-së edhe për shkaqe tjera, si pamundësia e ballafaqimit të parashtrueses*

me dëshmitarë dhe refuzimi i kërkesës për ekzaminim psikiatrik të së njëjtës gjë, në rastin konkret të parashtruesit Q. I. nuk janë çështje të diskutueshme.

v. Edhe Gjykata Themelore në Gjakovë (Aktgjykimi nr. 2022;230076), e edhe Gjykata Supreme [Aktgjykimi Pml. nr. 495/2023], kishin arsyetuar mungesën e psikologut gjatë marrjes në pyetje dhe mënyrën e marrjes në pyetje të të dëmtuarës së mitur në përputhje me dispozitat përkatëse të Kodit Nr. 06/L-006 të drejtësisë për të mitur (neni 112.2).

45. Në këtë kuptim, Gjykata vëren se parashtruesi në favor të pretendimeve të tij për mos praninë e psikologut gjatë marrjes në pyetje të të miturës viktimë, citoi vetëm fjalinë e parë të paragrafit 150 të Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KI161/21 lidhur me administrimin e drejtë të procesit, dhe jo tekstin burimor e të plotë të paragrafit i cili sqaron saktësisht specifikat e atij rasti, që nënvizon se: “Gjykata vë në dukje se nuk mund të ketë administrim adekuat dhe vlerësim të drejtë të dëshmisë së një fëmije, dëshmitarë të vetëm okular të ngjarjes përkatëse, pa mbështetje profesionale për qëllime të procedurës penale, në një procedurë në të cilën gjykohej çështja e vrasjes së babait të tij dhe e akuzuar ishte nëna e tij. Në këtë kuptim, Gjykata vëren një dështim të gjykatave të rregullta për trajtimin adekuat të një dëshmitari fëmijë, në një kontekst kaq specifik, si në rrethanat e rastit konkret kur dëshmitari X.X., është dëshmitar i dhunës në familje dhe është në përkujdesje shtetërore për shkak të pamundësisë që të jetë nën përkujdesjen prindërore”.
46. Parashtruesi në argumentimin e pretendimit të tij ka shmangur pjesën esenciale të paragrafit të referuar, ku Gjykata kishte bërë vlerësimin e rrethanave tepër specifike të rastit KI161/21, sikurse edhe pamundësinë e dëshmitarit fëmijë që **“të jetë në përkujdesje prindërore”**, kriter ky që në rastin e parashtruesit nuk është i aplikueshëm.
47. Gjykata vazhdimisht ka theksuar se bazuar në nenin 48 të Ligjit dhe paragrafët (1) (d) dhe (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës dhe praktikën e saj gjyqësore: se (i) palët kanë detyrim që të qartësojnë saktësisht dhe në mënyrë adekuate të paraqesin faktet dhe pretendimet; dhe gjithashtu (ii) të dëshmojnë dhe në mënyrë të mjaftueshme të mbështesin pretendimet e tyre për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese (shih, rastet e Gjykatës [KI163/18](#), parashtrues *Kujtim Lleshi*, paragrafi 85, dhe [KI124/20](#) parashtrues *Muhamed Ali CeysUlmedine*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 janarit 2021, paragrafi 42) dhe [KI221/21](#), parashtrues *Shpejtim Gacaferri*, Aktvendim për papranueshmëri, i 31 marsit 2022, par 55).
48. Parashtruesi nuk ofroi prova bindëse pse procesi gjyqësor në tërësinë e tij ishte i padrejtë ose pse garancitë procedurale nuk ishin respektuar nga gjykata që trajtuan rastin, andaj vetëm konstatimi se rasti i tij duhej të trajtohej në “... rrethanat dhe seriozitetin e rastit KI161/21” nuk përbën pretendim të bazuar që e shpie Gjykatën Kushtetuese për të gjetur shkelje të nenit 3 dhe nenit 31 në kuptimin e aplikimit të garancive procedurale sepse nuk ka prova për zbatim arbitrar të ligjit.
49. Përkitazi me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës lidhur me nenin 6 të KEDNJ-së lidhur me mënyrën e marrjes në pyetje të të dëmtuarës dhe aspektin e së drejtës për vendim të arsyetuar sipas nenit 31, siç u tha më sipër, parashtruesi i kërkesës kontestoi ligjshmërinë e provave dhe mënyrën e marrjes së këtyre provave dhe mosadresimin e pretendimeve të tij ankimore në aktgjykimet e kontestuara.
50. Gjykata lidhur me këto pretendime konstaton se e drejta për vendim të arsyetuar gjyqësor dhe parimet themelore lidhur me këtë të drejtë janë mirë të etabluara në praktikën e saj gjyqësore, të cilat ngërthejnë në vete gjithashtu edhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së.

51. Në raport me si më sipër, Gjykata u referohet parimeve të përcaktuara në rastin e saj [KI97/16](#) (shih Aktgjykimin e GJ.K.K. të 9 janarit 2018, parashtrues i kërkesës: *IKK – Classic*, paragrafët 45-52), të cilat si të përmbledhura përcaktojnë që: “vendimet e gjykatave dhe tribunaleve duhet t’i theksojnë në mënyrë adekuate arsyet në të cilat ato bazohen: se funksioni thelbësor i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve se janë dëgjuar dhe se arsyetimi i vendimit duhet të theksojë raportin ndërmjet konstatimeve të meritës dhe reflektimeve kur të merren parasysh provat e propozuara nga njëra anë, dhe konkluzionet ligjore të gjykatës nga ana tjetër” (shih po ashtu rastet e GJEDNJ-së: Aktgjykimin e GJEDNJ-së H. kundër Belgjikës, kërkesa 8950/80, paragrafi 53, të 30 nëntorit 1987 dhe Van de Hurk kundër Holandës, Aktgjykimi i 19 prillit 1994). Këto parime janë tërësisht të aplikueshme edhe në rastin e parashtruesit dhe gjykata nuk gjen arsye të devijojë nga kjo partiakë edhe në rastin e tanishëm.

Aplikimi i parimeve për të drejtën në vendim të arsyetuar në këtë rast

52. Në adresimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për mungesë të vendimit të arsyetuar e në dritën e parimeve të cekura si më sipër (rasti [KI97/16](#)), Gjykata konstaton që Gjykata Themelore në Gjakovë në Aktgjykimin e saj nr. 2022230076, të 19 prillit 2023, ka dhënë një arsyetim të gjerë dhe të plotë edhe sa i përket gjendjes faktike edhe lidhur me ligjin e aplikueshëm, ndërsa si prova kishte administruar: i) Raporti fillestar i incidentit i 4 nëntorit 2022, të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Policisë në Gjakovë; ii) raportin e hetueses V. K. i 4 nëntorit 2022; iii) raportin e oficeres policore B. H. i 4 nëntorit 2022; iv) raportin e hetueses V. K. të 10 nëntorit 2022; v) raportin nga operatori IPKO lidhur me listingun dhe hartografinë e 4 nëntorit 2022; vi) shikimin e CD në video-incizim; vii) shikimin në fotografitë e nxjerra nga rrjeti social snapchat; viii) shikimin e fotove të nxjerra nga video-incizimet në CD; si dhe shkresat e tjera në lëndë si: ix) ekstrakti nga regjistri qendror i gjendjes civile të 30 janarit 2023, i lëshuar nga MPB e Republikës së Kosovës, Zyra e Gjendjes Civile e Komunës së Gjakovës, si dhe nga mbrojtja e të akuzuarit.
53. Gjykata Themelore në Gjakovë në Aktgjykimin e saj ka arsyetuar se “Dëgjimi i të dëmtuarës është bërë përmes rrjetit "Skype"⁵, për arsye të krijimit të ambientit më të përshtatshëm për të, ngase e njëjta nuk ka pasur dëshirë që të jetë prezent në të njëjtën sallë, ku ka qenë edhe i akuzuari, duke respektuar edhe dispozitat e nenit 112, paragraf 2 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, ku gjatë dëgjimit të saj prezentë ka qenë edhe përfaqësuesi i QPS – Organi i Kujdestarisë në Gjakovë E. H. si person mbështetës i të dëmtuarës”.
54. Po ashtu, Gjykata Themelore i ishte referuar edhe çështjes e mos pranisë së psikologut gjatë marrjes në pyetje të të dëmtuarës së mitur–dëshmitare, ku në aktgjykim kishte theksuar se: “Po ashtu, duke u bazuar në dispozitat e Kodit të Drejtësisë për të Mitur, që marrja në pyetje e të dëmtuarëve – viktimë të mitura duhet të bëhet me ndihmën e psikologut, mirëpo në mungesë të psikologut, atëherë marrja në pyetje mund të bëhet edhe përmes gjyqtarës për të mitur, ashtu siç e parasheh dispozita e nenit 112, paragrafi 4 nënparagrafi 4.2 të KDM-së, në rastin konkret në pamundësi të sigurimit të pranisë së psikologut, marrja në pyetje është bërë përmes gjyqtarës për të mitur”.
55. Gjykata Themelore më tej kishte konstatuar në aktgjykimin e saj se deklaratat e të dëmtuarës në polici dhe në seancë gjyqësore ishin konsistente dhe iu dha besimin e plotë, ndërsa lidhur me pretendimin e përfaqësuesit të parashtruesit për mënyrën e marrjes së provave, veçanërisht atyre të komunikimit telefonik, Gjykata Themelore arsyetoi: “Sa i përket pretendimit të mbrojtësit së listingut dhe hartografia mund të urdhërohen vetëm nga gjyqtari i procedurës paraprake konform nenit 91 të Kodit

04 /L-123 të Procedurës Penale, Gjykata thekson me Kodin e lartcekur hartografia e as listingu-regjistrimi i thirrjeve telefonike nuk janë paraparë si masa të fshehta, andaj prokurori ka mundur që urdhrin e tillë ta lëshoj në bazë të kompetencës së tij. Gjykata vë në dukje se me Kodin nr. 08/L-032 të Procedurës Penale, në mënyrë taksative, në nenin 86 janë listuar masat që mund të lëshohen nga Prokurori i Shtetit, pa pasur nevojë të konfirmohen nga gjyqtari i procedurës paraprake, e që ndër to është listuar edhe regjistrimi i thirrjeve telefonike, e që nuk lënë hapësirë për interpretimin ndryshe në të ardhmen”.

56. Gjykata Themelore kishte arsyetuar edhe pretendimin lidhur me joligjshmërinë e “përgjimeve elektronike” duke sqaruar përmbajtjen e nenit 10 të Ligjit për përgjimin e komunikimeve elektronike nr. 05/L-030 dhe ka konstatuar se “gjykata e konsideron të pabazuar dhe vlerëson se provat janë marrë në mënyrë të rregullt”.
57. Në fund, Gjykata Themelore në Aktgjykimin e saj ka theksuar se: “Gjykata ka vlerësuar me shumë kujdes të gjitha provat e administruara në seancën për caktimin e dënimit dhe të njëjtat i vlerësoi një nga një dhe në lidhje me njëra-tjetrën konform nenit 356, paragrafi 8 të KPP-së lidhur me nenin 360, paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së dhe ka ardhur në përfundim se me shqiptimin e dënimit me burg në kohëzgjatje prej 3 viteve e 6 muaj, është dënim i drejtë në përputhje me shkallën e dëmit të krimit të kryer nga ai në dëm të dëmtuarës së mitur dhe vlerëson se edhe me këtë sanksion do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së që konsiston në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të parandaloj personat e tjerë në kryerjen e veprave penale si dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit”.
58. Gjykata e Apelit në aktgjykimin e saj PAKR nr. 371/23 të 5 korrikut 2023 kishte shqyrtuar pretendimet ankimore të paraqitura në ankesë, përfshirë ato që kanë të bëjnë me konstatimin e gjendjes faktike dhe zbatimin e ligjit sikurse që kishte vlerësuar aktgjykimin edhe sipas obligimeve ligjore që dalin nga detyra zyrtare e gjykatës së shkallës së dytë dhe kishte konstatuar se ankesa e parashtruar duhet të refuzohet.
59. Kolegji për të mitur i kësaj gjykate, pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale nuk kanë mbështetje ligjore, dhe se “bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale, nuk qëndron fakti se procedura penale është iniciuar në bazë të indicjeve apo supozimeve me arsyetimin se rasti është paraqitur në polici, nga prindërit e të miturës, këto pretendime qëndrojnë se vërtetë një pjesë e madhe e rasteve penale, mund të fillojë në bazë të indicjeve se është apo nuk është kryer ndonjë veprim i kundërligjshëm, si dhe për faktin se kush tjetër përveç përfaqësuesve ligjor të të miturve do të duhej të iniciojë një procedurë penale, kur konsiderohet se këto veprime janë ndërmarrë ndaj fëmijëve të tyre, por edhe për faktin se një gjë e tillë është detyrim jo alternativ”.
60. Gjykata e Apelit-Kolegji për të mitur gjithashtu konstatoi se pretendimet ankimore lidhur me lartësinë e dënimit të shqiptuar me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore i vlerësoi si të pabazuara dhe konstatoi se: “Gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar dhe konstatuar drejtë të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, ku si rrethana lehtësuese ka vlerësuar faktin se i akuzuari është i moshës së re, në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i moshës 21 vjeçare, qëndrimi i tij korrekt para gjykatës, i njëjti ka pasur sjellje të mira në gjykatë”.

61. Po ashtu, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit vlerësoi edhe rrethanat rënduese ku theksoi se *“Gjykata ka pasur parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, ku i njëjti veprën penale e ka kryer me dashje dhe vetëdije të plotë, dhe ka shfrytëzuar situatën duke keqpërdorur fëmijën e moshës 14 vjeçare, papjekurinë e saj krahasuar me moshën, po ashtu gjykata ka pasur parasysh karakteristikat personale të të akuzuarit para kryerjes së veprës penale, ku i njëjti ka qenë i dënuar më parë për vepra tjera penale, që konstatohen nga evidenca penale e kësaj gjykate”*.
62. Gjykata gjithashtu vëren se edhe Gjykata Supreme e Kosovës ka dhënë arsyetime të qarta në Aktgjykimin Pm1. nr. 495/2023, me të cilin refuzoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të parashtruesit të kërkesës.
63. Gjykata Supreme, ndër të tjera, në aktgjykimin e saj lidhur me dëshminë e të dëmtuarës theksoi: *“Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se pretendimet përkitazi me dëshminë e të dëmtuarës gjithashtu janë të pabazuara, meqë sipas shkresave të lëndës del se e njëjta ka qenë konsistente në dëshminë e saj në të gjitha fazat e procedurës penale dhe se deklarimi i saj del të jetë i natyrshëm dhe i qartë dhe duke përshkruar ngjarjen e ndodhur, për më tepër, nuk u gjet as edhe një motiv i vetëm që e njëjta të ketë denoncuar në mënyrë të rrejshme të dënuarin”*.
64. Më tutje, sa i përket pretendimit për marrje në pyetje pa praninë e psikologut të të dëmtuarës-dëshmitare të mitur, Gjykata Supreme arsyetoi se: *“Duke vlerësuar pretendimin përkitazi me marrjen në pyetje të të dëmtuarës në mungesë të psikologut, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e saj ka paraqitur arsyetimin e saj përkitazi me mungesën e psikologut dhe në mungesë të tij, gjyqtarja për të mitur ka marrë rol aktiv marrjen në pyetje e të viktimës është bërë përmes gjyqtarës dhe me këtë edhe është plotësuar mungesa e psikologut, siç është përcaktuar me dispozitën e nenit 112, par.4 nënpar.4.2 të KDM-së dhe me këtë rast nuk është cenuar Kushtetuta e Kosovës, Konventa për të Drejtat e Fëmijës dhe Konventa e Stambollit, siç pa bazë pretendohet në kërkesën e mbrojtësit të të dënuarit”*.
65. Dhe në pjesën përmbyllëse të aktgjykimit, Gjykata Supreme kishte konstatuar se: *“Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se gjykatat e dy instancave më të ulëta gjyqësore me të drejtë kanë konstatuar se në veprimet e të dënuarit janë realizuar të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale të sulmit seksual nga neni 229 par.5 lidhur me par. 1 të KPRK-së, meqë siç është përshkruar në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, përkatësisht nga përshkrimi i figurës së kësaj vepre penale dhe shkresat e lëndës rrjedh se në rastin konkret i dënuari ka vepruar ndaj të dëmtuarës për qëllime seksuale. Arsyetimet dhe gjetjet e dy gjykatave të dy instancave më të ulëta gjyqësore, përkitazi me përmbushjen e elementeve të veprës penale i aprovon në tërësi edhe Gjykata Supreme e Kosovës”*.
66. Duke u bazuar në si më sipër, marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës, veçoritë dalluese të rastit të parashtruesit me rastin të pretenduar si të ngjashëm (KI161/21) sikurse janë elaboruar më lart, Gjykata konstaton se mënyra e marrjes në pyetje të të dëmtuarës së mitur në raport me rrethanat e rastit konkret (asistimi i prindërve, mënyra e dhënies së deklaratës me video link, dëshmitë tjera plotësuese të siguruara nga Gjykata Themelore), pastaj arsyetimet e gjëra dhe të plota të aktgjyqimeve të gjykatave të rregullta të tri shkallëve, përgjigjja e gjykatave të rregullta në pretendimet ankimore të parashtruesit të kërkesës, nuk ofrojnë bazë që Gjykata Kushtetuese të konstatojë shkelje të nenit 31 të Kushtetutës lidhur me nenin 6 të KEDNJ-së, sepse parashtruesi nuk i ka mbështetur me fakte pretendimet e tij.
67. Mbi bazën e të njëjtave arsyetime, Gjykata nuk gjen argumente se vendimet gjyqësore të kontestuara kanë shkelur nenin 22 dhe nenin 50 të Kushtetutës dhe nenin 3 të

Konventës për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Konventës së Stambollit, ngase përpos referimit në rastin e Gjykatës KI161/21, parashtruesi i kërkesës nuk paraqiti argumente tjera që do të mbështesnin shkeljet e pretenduara.

68. Bazuar në si më sipër, Gjykata konkludon se parashtruesi kërkesës nuk arriti të mbështes pretendimet e tij dhe të vërtetojë në baza kushtetuese se Gjykata Supreme i mohoi të drejtat kushtetuese, andaj të njëjtat i deklaroi si pretendime të pambështetura dhe rrjedhimisht qartazi të pabazuara mbi bazën e rregullit 34.2 të Rregullores së punës.

Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 32 të Kushtetutës [E drejta për mjete juridike]

69. Parashtruesi në kërkesë nuk ka dhënë arsyttime se si dhe pse kjo e drejtë kushtetuese i është shkelur, porse nga shkresat e rastit, Gjykata vëren se ai kishte në dispozicion të gjitha mjete juridike të parapara me ligj dhe të njëjtat i shfrytëzoi në procesin gjyqësor të zhvilluar kundër tij.
70. Nga shkresat e lëndës konstatohet se parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë më 10 qershor 2023, ndërsa kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit paraqiti kërkesë për Mbrojtje të Ligjshmërisë më 13 shtator 2023.
71. Në dritën e fakteve të cekura si më sipër, Gjykata nuk gjen se parashtruesit i është shkelur e drejta për mjete juridike sipas nenit 32 të Kushtetutës dhe vetëm përmendja e shkeljes në kërkesë pa sqarime bindëse e të mbështetura me fakte nuk është bazë e mjaftueshme për Gjykatën për të konkluduar se ka shkelje të së drejtës kushtetuese në fjalë.

Vlerësimi i kërkesës për masë të përkohshme

72. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës kërkon që Gjykata të vendos masë të përkohshme, duke arsyetuar atë kërkesë me faktin se *“Si mbajtës i familjes, parashtruesi i kërkesës ka përgjegjësi të mëdha. I njëjti është burimi kryesor i mbështetjes financiare për familjen dhe kujdesemi për nevojat e të gjithë anëtarëve ...”*.
73. Gjykata konstaton se në bazë të rregullit 44 (3) të Rregullores së punës, parashihet që:
Kërkesa për masë të përkohshme duhet të paraqitet me shkrim, duhet të përshkruajë faktet përkitazi me kërkesën, argumentet për të mbështetur kërkesën, masat e kërkuara dhe pasojat e parashikuara në mënyrë të arsyeshme nëse kërkesa miratohet.
74. Duke marrë për bazë faktin se kërkesa e parashtruesit në tërësinë e saj shpallet e pa pranueshme, Gjykata nuk gjen bazë për ta aprovuar kërkesën për masë të përkohshme.

Kërkesa për moszbulim të identitetit të palëve

75. Gjykata gjithashtu rikujton se parashtruesi i kërkesës kërkon që identiteti i palëve në procedurë në këtë rast të mos zbulohet. Në arsyetimin e kërkesës së tij, parashtruesi ka theksuar natyrën e veprës penale duke apostrofuat se: *“Duke marrë parasysh se procedura gjyqësore ka të bëjë me sulmin seksual ndaj të miturës ...”*.
76. Në raport me kërkesën si më sipër, Gjykata i referohet rregullit 24 të Rregullores së punës lidhur me moszbulimin e identitetit të palëve, i cili rregull përcakton:
- (2) Gjykata vendosë lidhur me kërkesën e palës për moszbulim të identitetit me miratimin e shumicës së gjyqtarëve.*
- [...]
- (4) Në rast të moszbulimit të identitetit, pala identifikohet vetëm me iniciale, shkurtesa ose një (1) shkronjë të vetme.*
77. Gjykata në raport me kërkesën e parashtruar për moszbulim të identitetit të palëve konstaton se duke marrë parasysh natyrën e veprës penale për të cilën është dënuar parashtruesi i kërkesës, ndjeshmërinë e rastit, moshën e viktimës së rastit dhe pasojat eventuale që mund t'i ketë publikimi i emrave të palëve në këtë rast, kërkesa për moszbulim identiteti duhet të aprovohet, rrjedhimisht emrat e palëve të rastit në këtë aktvendim janë referuar vetëm me inicialet e tyre (shih rastin [KI122/19](#), parashtruesi i kërkesës *F.M.* Aktvendim për papranueshmëri, i 28 gushtit 2020 par.117).

Përfundim

78. Gjykata pas shqyrtimit të fakteve të paraqitura në kërkesë, pretendimeve të ngritura të parashtrueses së kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenet 3, 22, 31, 32 dhe 50 të Kushtetutës, sikurse edhe nenit 3 të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve dhe Konventës së Stambollit (pa nen të specifikuar), në harmoni me praktikën e saj gjyqësore dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së konstaton se, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 34, paragrafi (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, nenet 47 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 34 (2) të Rregullores së punës, më 26 qershor 2024

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË, njëzëri, kërkesën të papranueshme;
- II. TË REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;
- III. TË MIRATOJË me tetë (8) vota për dhe një (1) kundër kërkesën për mos zbulim të identitetit;
- IV. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- V. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- VI. Ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit;

Gjyqtari raportues



Nexhmi Rexhepi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka-Nimani